



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1647 prot.

Tiranë më, 13.06.2019

URDHËR

Nr. 101, datë 12.06.2019

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR EMËRIMIN E ZËVENDËSDREJTUESIT TË
PROKURORISË NË PROKURORITË ME JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM”**

Në mbështetje të nenit 148/b shkronja “dh” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve 38 pika 2 shkronja “k” e 44 pika 6 të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”,

Me synim, përmirësimin e drejtimit të prokurorive dhe miratimin e rregullave për emërimin e zëvendësdrejtuesit të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm.

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për emërimin e zëvendësdrejtuesit të prokurorisë në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, sipas tekstit bashkëlidhur.

2. Me zbatimin e këtij urdhri ngarkohen prokurorët, drejtuesit dhe punonjësit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apeleve me juridiksionit të përgjithshëm.

3. Urdhri nr.329, datë 29.12.2016 i Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e rregullave për emërimin e zëvendësdrejtuesit të prokurorisë”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ARTA MARKU



RREGULLORE

PËR EMËRIMIN E ZËVENDËSDREJTUESIT TË PROKURORISË NË PROKURORITË ME JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të nenit 148/b shkronja “dh” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve 38 pika 2 shkronja “k” e 44 pika 6, në lidhje me nenet 21, 55 e 56 të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;

Me synim, për të përcaktuar kriteret e përzgjedhjes dhe mënyrën e organizimit të procesit për emërimin e zëvendësdrejtuesit të prokurorive, si dhe për të parandaluar mungesën e drejtimit të prokurorive me juridiksion për përgjithshëm, normohen rregullat e detajuara, si vijojnë:

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1. Kjo rregullore parashikon rregulla të detajuara, për kriteret e përzgjedhjes, mënyrën e organizimit të procesit të zgjedhjes dhe emërimit të zëvendësdrejtuesit të prokurorisë në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe në prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm.

Neni 2

Kriteret e përzgjedhjes së zëvendësdrejtuesit

1. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë ku janë ngritur/krijuar seksione, zëvendësdrejtuesi i prokurorisë zgjidhet nga radhët e drejtuesve të seksioneve që plotësojnë këto kriteret¹:

a) ka të paktën pesë vjet përvojë si prokuror, nga të cilat të paktën tre vjet në të njëjtin nivel prokurorie;

b) është vlerësuar “shumë mirë” në tre vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale.

2. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë ku nuk janë ngritur/krijuar seksione² dhe në prokuroritë pranë gjykatave të apeleve, zëvendësdrejtuesi i prokurorisë zgjidhet nga radhët e prokurorëve që plotësojnë këto kriteret:

a) ka të paktën pesë vjet përvojë si prokuror, nga të cilat të paktën tre vjet në të njëjtin nivel prokurorie;

b) është vlerësuar “shumë mirë” në tre vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale.

¹ Shih, nenin 44 pika 3 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

² Shih, po aty nenin 21 “Seksionet në prokurori” që në pikën 1 parashikon: “1.Në çdo prokurori, për kategori të caktuara veprash penale, **kur është e mundur dhe e nevojshme**, drejtuesi i prokurorisë krijon seksione...”

3. Në rastet kur asnjëri drejtues seksioni apo prokuror nuk plotëson kriteret e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, zëvendësdrejtuesi i prokurorisë zgjidhet nga radhët e prokurorëve që plotësojnë këto kriteret:

- a) ka përvojën profesionale më të gjatë si prokuror;
- b) ka vlerësime të nivelit më të lartë në tre vlerësimet e fundit të performacës etike dhe profesionale;
- c) nuk ka masa disiplinore dhe/ose nuk është filluar procesi disiplinor ndaj tij.

Neni 3

Thirrja dhe përgatitja e mbledhjes

1. Mbledhja e prokurorëve të prokurorisë për të marrë mendimin e tyre për emërimin e zëvendësdrejtuesit thirret dhe kryesohet nga drejtuesi i prokurorisë³.

2. Data, vendi dhe rendi i ditës u njoftohet prokurorëve të paktën tre ditë para zhvillimit të mbledhjes dhe shoqërohet nga relacionin/listën përkatëse⁴.

3. Kancelari ndihmon dejtuesin e prokurorisë në përgatitjen e mbledhjes së prokurorëve dhe është veçanërisht përgjegjës për:

- a) Njoftimin e prokurorëve për datën dhe orën e mbledhjes;
- b) Mbledhjen e formularëve të shprehjes së interesit nga prokurorët që duan të kandidojnë për zëvendësdrejtues, sipas modelit aneks 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje;
- c) Përgatitjen e një relacioni me listën emërore të prokurorëve kandidatë që plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 2 të kësaj rregulloreje⁵ dhe ia paraqet drejtuesit të prokurorisë.
- ç) Përgatitjen e fletës të listimit të votave të komisionit votimit, sipas modelit aneksi 2 bashkëlidhur kësaj rregulloreje;
- d) Mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes⁶.

4. Në mungesë të kancelarit, këto përgjegjësi i ushtron kryesekretari/ja i prokurorisë dhe në mungesë të tij/saj, sekretari/sekretarja me përvojën profesionale me të gjatë në atë prokurori.

5. Drejtuesi i prokurorisë verifikon përmbushjen e kriterëve të kandidatëve dhe kundërfirmon relacionin me listën emërore të kandidatëve.

Neni 4

Pjesëmarrja dhe procedura e zgjedhjes

1. Në mbledhje marrin pjesë të gjithë prokurorët të cilët kanë të drejtë të votojnë.

³ Shih, po aty piken 1 të nenit 55;

⁴ Shih, po aty piken 1 të nenit 55;

⁵ Shih, Për të përgatitur relacionin me listën përkatëse, sipas rastit, drejtuesi i prokurorisë ose kancelari apo kryesekretari mund të kërkojë informacion për prokurorët kandidat për zëvendësdrejtues në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Shih, po aty piken 1 të nenit 55;

⁶ Shih, po aty piken 3 të nenit 56;

2. Mbledhja hapet nga drejtuesi i prokurorisë, i cili lexon emrat e kandidatëve për zëvendësdrejtues⁷.

3. Drejtuesi cakton komisionin e votimit ku merr pjesë kancelari, kryesekretari/ja dhe/ose sekretarja me përvojë profesionale më të gjatë në atë prokurori.

a) Në mungesë të kancelarit dhe/ose kryesekretarit/es, në komision caktohet sekretari i radhës me përvojën më të gjatë në atë prokurori.

b) Kancelari, ose në mungesë të tij kryesekretari/ja, drejton komisionin e votimit.

4. Me kërkesë të secilit prokuror pjesëmarrës, diskutohet mbi kandidaturat për zëvendësdrejtues.

5. Votimi është i hapur dhe mendimi/rekomandimi për kandidatin fitues merret me shumicën e votave të prokurorëve të pranishëm.

6. Në përfundim të diskutimeve, secili prokuror jep mendimin për një nga kandidatët për zëvendësdrejtues në atë prokurori.

a) Kancelari ose kryesekretari/ja, mendimet/opinionet dhe votimin e prokurorëve për secilin kandidat për zëvendësdrejtues i pasqyron në procesverbalin e mbledhjes.

b) Komisioni i votimit bën numërimin e votave për secilin kandidat, të cilat i liston sipas radhës në formularin "*Fleta e listimit të votave për kandidatët për zëvendësdrejtues të prokurorisë*", aneksi 2 i kësaj rregullore, duke vendosur të parin, kandidatin që ka marrë numrin më të lartë të votave.

7. Prokurori kandidat që ka marrë numrin më të lartë të votave shpallet nga komisioni si kandidati për të cilin është dhënë mendimi për zëvendësdrejtues nga mbledhja e prokurorëve.

Neni 5

Emërimi i zëvendësdrejtuesit

1. Drejtuesi i prokurorisë, pasi merr mendimin e mbledhjes së prokurorëve, emëron zëvendësdrejtues të prokurorisë kandidatin e zgjedhur prej tij. Mendimi i marrë nga mbledhja e prokurorëve nuk është i detyrueshëm për drejtuesin e prokurorisë.

2. Në rastet kur numri i prokurorëve në prokurori është dy, prokurori që nuk është drejtues konsiderohet i emëruar zëvendësdrejtues⁸. Në këtë rast, zëvendësdrejtuesi përfaqëson prokurorinë në rast mungese dhe me autorizim të drejtuesit ose kur vendi i tij mbetet përkohësisht i lirë.

3. Në rastet kur në një prokurori, asnjëri nga prokurorët nuk është drejtues dhe nuk ka të emëruar zëvendësdrejtues, deri në emërimin e drejtuesit, prokurori me përvojën profesionale më të gjatë si prokuror, që plotëson kriteret e nenit 2, pika 3, shkronja "c" të kësaj rregullore, konsiderohet i emëruar zëvendësdrejtues i prokurorisë⁹. Në këtë rast, zëvendësdrejtuesi përfaqëson prokurorinë në mungesë të drejtuesit vendi i të cilit ka mbetur përkohësisht i lirë.

⁷ Shih, po aty piken 1 të nenit 56;

⁸ Shih, nenin 7 të vendimin nr.7 date 21 Dhjetor 2018 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave" për aq sa mund t'i referohemi.

⁹ Shih, po aty nenin 7.

4. Në rastet kur zëvendësdrejtuesi nuk mund të ushtrojë detyrat e tij ose për çdo arsye pushon së vepruari si prokuror në atë prokurori, ai zëvendësohet sipas kriterëve dhe procedurës së përcaktuar në ligj¹⁰ dhe në këtë rregullore.

Neni 6 **Përgjegjësia disiplinore**

Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore përbën shkelje disiplinore sipas ligjit.¹¹

Neni 7 **Zbatimi dhe mbikëqyrja**

1. Kjo rregullore është e detyrueshme për zbatim nga prokurorët, drejtuesit dhe punonjësit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm¹².

2. Me mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregulloreje ngarkohen drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe drejtuesi e prokurorët e strukturës përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

Neni 8 **Hyrja në fuqi dhe publikimi**

Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm dhe publikohet në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme.

¹⁰ Shih, po aty nenin 44 pika 5 të ligjit 97/2016

¹¹ Shih, nenin 148/d paragrafi 1 i Kushtetutës.

¹² Shih po aty, nenin 44 pika 6 të ligjit 97/2016

KËRKESË

PËR

SHPREHJE INTERESI PËR POZICIONIN E ZËVENDËSDREJTUESIT TË PROKURORISË

Drejtuar: Drejtuesit të Prokurorisë

KËTU

Unë i nënshkruari _____, me detyrë, shef seksioni/prokuror në Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë/Gjykatës së Apelit _____, bazuar në nenin 44 pika 3 e ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, paraqes kandidaturën time, për t’u emëruar në detyrën e zëvendësdrejtuesit të prokurorisë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, ju uroj punë të mbarë.

Me konsideratë,

Prokuror

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë/Gjykatës së Apelit _____

Sot, në datën __.__.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË/GJYKATËS SË APELIT

FLETA E LISTIMIT TË VOTAVE
PËR
KANDIDATËT PËR ZËVENDËSDREJTUES TË PROKURORISË

Nr.	Emri, mbiemri, i kandidatit	Numri i votave
1.		
2.		
3.		
4.		

KOMISIONI I VOTIMIT

 (Emri, mbiemri, anëtar)

 (Emri, mbiemri, kryetari)

 (Emri, mbiemri, anëtar)